

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Komuna Kaçanik shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Ekonomisë
Titulli i pozitës së punës	Zyrtar për Zhvillim
Klasa e pozitës	Profesional 2
Koeficienti/Paga	GJ37-4.9
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	26/12/2023
Afati për aplikim	27/12/2023 - 25/01/2024
Institucioni	Komuna Kaçanik
Departamenti	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit
Divizioni	Sektori i turizmit dhe zhvillimit ekonomik
Vendi i punës	Kaçanik
Nr. i Referencës	RN00013040
Kodi	RPC0006579

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësishë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
2. Zhvillon aktivitetet rreth përgatitjes dhe hartimit të planeve të zhvillimit global strategjik të komunës për periudha të caktuara afatgjate dhe afatshkurtër ;
3. Krijon parakushtet për nxitjen dhe përmirësimin e ambientit afarist lokal dhe këshillon përfaqësuesit e bizneseve locale për qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në financa përmes ndërmjetësimit në mes të institucioneve financiare vendore dhe ndërkombëtare dhe bizneseve të ndryshme lokale;
4. Harton analizat e kostove përfituese për projektet e mëdha të investimeve publike (pip dhe cba) si dhe bënë analizat për projektet konkrete (swot-analizat) ;
5. Koordinon aktivitetet rreth promovimit të investimeve. Komunikon me investitorët potencial dhe siguron një bashkëveprim të vazhdueshëm duke dhënë udhëzime dhe këshilla të ndryshme për mundësinë e angazhimit të kapitalit të tyre në veprimtaritë prodhuese dhe shërbyese;
6. Bashkëvepron me komunitetin e biznesit, krijon kushtet dhe mundësinë e promovimit të produkteve prodhuese dhe shërbimeve të ndërmarrjeve lokale përmes organizimit dhe pjesëmarrjes në panairë të ndryshme me karakter reklamues dhe komercial, poashtu përvetëson praktikën nga panairët tjera (tradicionale) të mallrave të ndryshme të prodhuara nga bizneset qoftë në vend apo jashtë vendit;
7. Merr pjesë në grupe punuese, organizimin e konferencave të ndryshme rreth zhvillimit ekonomik lokal me qëllim të përvetësimit dhe zbatimit të praktikave të reja në komunë;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

2.Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.



3. Kërkesat e përgjithshme formale

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në Fakultetin Ekonomik
- Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione deficitare (TIK);
- **Kualifikime të posaçme formale:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase;
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë
- Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet së paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- Dëshminë që nuk ka masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion;
- Çertifikatë/vërtetim nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilën dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit dhe kopja e dëshmisë se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore, dorëzohen gjatë fazës së verifikimit para emërimit;

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 09/02/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



7. Kriteret specifike shtesë

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

-

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

